

Rregullat e stadiumit për finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022

1. Fushëveprimi

Këto rregulla të stadiumit, së bashku me ligjet përkatëse kombëtare ose lokale në fuqi dhe çdo politikë dhe procedurë në fuqi në lidhje me masat sanitare, do të zbatohen për të gjithë mbajtësit e biletave dhe/ose të akreditimit që hyjnë në ambientet e stadiumit, të përdorura në lidhje me finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022, në pronësi të Unionit të Shoqatave Evropiane të Futbollit (tani e tutje "UEFA") dhe organizuar nga shoqata pritëse e finales së UEFA Europa Conference League™ 2022, përkatësisht Federata Shqiptare e Futbollit (tani e tutje "Shoqata pritëse").

Stadiumi (tani e tutje "Stadiumi"), siç referohet në këto rregulla të stadiumit, do të përfshijë të gjitha zonat brenda ambienteve të stadiumit dhe afërsinë e tij të menjëhershme ku do të luhet, po luhet ose është luajtur ndeshja finale e UEFA Europa Conference League™ 2022, të cilat janë të aksesueshme vetëm me një biletë ndeshjeje të finales UEFA Europa Conference™ 2022 (tani e tutje "Bileta") dhe/ose një akreditim të Finales UEFA Europa Conference™ 2022 (tani e tutje "Akreditimi"), duke përfshirë të gjitha hyrjet dhe daljet.

Këto rregulla të stadiumit dhe lista e artikujve të ndaluar, për periudhën gjatë së cilës nevojitet një biletë ose akreditim për të hyrë në stadium, (në varësi të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe nëse nuk njoftohet ndryshe nga UEFA) do të zëvendësojnë rregullat e stadiumit që rregullon ndeshjet dhe/ose ngjarjet e tjera të luajtura dhe/ose të mbajtura në stadium gjatë periudhave të tjera.

Rregullat e stadiumit do të jenë të disponueshme në faqen zyrtare të UEFA-s në www.uefa.com/tirana dhe në hyrjet si dhe brenda stadiumit gjatë të gjithë kohës së periudhës së zbatimit të rregullave të stadiumit.

Përveç këtyre rregullave të stadiumit, të gjithë personat duhet të respektojnë çdo kod sjelljeje për spektatorët ose kodin e sjelljes për personat e akredituar (sipas zbatimit) i cili është vendosur nga UEFA për finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022.

2. Hyrja

- 2.1. Hyrja në stadium do të autorizohet vetëm me paraqitjen e një bilete dhe/ose akreditimi të vlefshëm për çdo person individual, pavarësisht nga mosha. Bileta dhe/ose akreditimi duhet të tregohen për inspektim në hyrje dhe brenda stadiumit nëse kërkohet nga çdo person i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficer policie. Nëse kërkohet, dëshmia e identitetit duhet të paraqitet në formën e një dokumenti zyrtar. Nëse nuk bashkëpunoni kjo do të rezultojë në refuzimin e hyrjes në stadium ose përjashtimin nga stadiumi.
- 2.2. Vlefshmëria dhe shfrytëzimi i biletave ose akreditimeve do të përcaktohen sipas termave dhe kushteve përkatëse të Finales së UEFA Europa Conference League™ 2022. Mbajtësit e biletave ose të akreditimit mund të hyjnë në stadium vetëm me një biletë ose akreditim që është marrë/dhënë dhe përdoret në përputhje me këto terma dhe kushte. Biletat ose akreditimet që janë marrë nga burime të paautorizuara do të jenë të pavlefshme.

- 2.3. Mbajtësit e biletave nën moshën 16 vjeç do të autorizohen të hyjnë në stadium vetëm me një të rritur shoqërues, i cili do të jetë përgjegjës për ta. I rrituri shoqërues duhet të ketë gjithashtu një biletë të vlefshme.
- 2.4. Personat me aftësi të kufizuara do të mund të arrijnë në zonat e aksesueshme nëpërmjet hyrjeve të parashikuara për këtë qëllim, duke paraqitur një biletë të vlefshme për personat me aftësi të kufizuara. Çdo person shoqërues duhet të ketë gjithashtu një biletë të vlefshme. Dëshmia e aftësisë së kufizuar duhet të tregohet nëse kërkohet nga çdo person i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse.
- 2.5. Drejtimi dhe parkimi i automjeteve në stadium do të lejohet vetëm me autorizimin e posaçëm të UEFA-s dhe/ose shoqatës pritëse.

3. Kontrollat personale

- 3.1. Çdo person që hyn në stadium do të jetë i detyruar të tregojë dhe nëse kërkohet, t'i dorëzojë për inspektim biletën dhe/ose akreditimin e tij një personi të caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficeri policie.
- 3.2. Çdo person i emëruar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficer policie, do të ketë të drejtën të shqyrtojë – duke përfshirë përdorimin e mjeteve ndihmëse teknike – nëse personat përfaqësojnë një rrezik të mundshëm të prishjes së rendit publik, veçanërisht nëse ata kanë konsumuar alkool ose drogë ose kanë armë ose sende të tjera të ndaluara. Çdo person i kualifikuar i emëruar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficer policie, do të ketë të drejtën të kontrollojë veshjet e çdo personi dhe sendet e tjera në zotërim të tyre.
- 3.3. Artikujt e ndaluar do të konfiskohen nga çdo person i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose do të duhet të lihen, kur dhe nëse është e mundur, në vendin për depozitimin e çantës nga pronari i tyre. Personat e emëruar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse kanë të drejtë të refuzojnë të ruajnë disa sende në vendin ku depozitohen çantat.
- 3.4. Çdo person që refuzon të respektojë rregullat e stadiumit ose përbën rrezik sigurie do të largohet dhe do t'i mohohet qasja në stadium, pa paragjykuar çdo veprim tjetër që mund të ndërmerret kundër atij personi.
- 3.5. Çdo personi që përdor në mënyrë të paautorizuar një biletë ose është subjekt i një ndalimi të zbatueshëm në stadium do t'i mohohet qasja në stadium dhe ai do t'ia kthejë menjëherë biletën UEFA-s dhe/ose shoqatës pritëse (siç udhëzohet), në përputhje me kushtet dhe termat e biletave. Rregulla të ngjashme do të zbatohen për çdo përdorim të një akreditimi që nuk është në përputhje me termat dhe kushtet e akreditimit.

4. Sjellja brenda stadiumit

- 4.1. Të gjithë personat që hyjnë në stadium duhet:
- a) të zbatojnë çdo politikë dhe procedurë në fuqi në lidhje me masat sanitare;
 - b) të sillen në mënyrë të tillë që të mos dëmtojnë, lëndojnë, rrezikojnë ose pengojnë ose bezdisin pa nevojë të tjerët ose të shkaktojnë ndonjë dëm;
 - c) të ndjekin udhëzimet e personave të caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse, ose policia, brigada e zjarrfikësve ose shërbime të tjera shpëtimi;
 - d) të zënë vendin e caktuar për ta siç tregohet në biletën e tyre dhe të përdorin rrugët e duhura të hyrjes. Një person do të jetë i detyruar të ulet në një vend të ndryshëm nga ai i treguar në

biletën e tij, nëse kërkohet nga një person i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficer policie, për arsye sigurie ose organizative/operative.

4.2. Ndalohet:

- a) hedhja e çdo lloj objekti nga tribuna në fushë; dhe
- b) hyrja në fushë nga tribuna

dhe çdo person që shkel këto dispozita mund të ndiqet penalisht.

- 4.3. Nëse një person ka dijeni për ndonjë dëm të shkaktuar në ndonjë pronë, ose ndonjë aksident të çfarëdo lloji, ai person duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të informuar një person të caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose një oficer policie.
- 4.4. Qasja do të jetë rreptësisht e kufizuar nga të drejtat që i garantohen mbajtësit të një bilete, një akreditimi dhe/ose kur është e nevojshme, një pajisje shtesë aksesit.
- 4.5. Mund të bëhen kërkesa të tjera të jashtëzakonshme për të parandaluar, zvogëluar ose eliminuar rrezikun për jetën, shëndetin ose pronën. Udhëzimet e lëshuara nga një person i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse, ose një oficer policie, duhet të ndiqen dhe mosbashkëpunimi mund të rezultojë në përjashtimin nga stadiumi.
- 4.6. Mbeturinat dhe ambalazhet e zbrazëta do të vendosen në kazanët dhe kontejnerët e ofruar në stadium. Çdo rregullim për ndarjen e mbetjeve do të respektohet.
- 4.7. Ndalohet pirja e duhanit në stadium, -duke përfshirë përdorimin e produkteve të cigareve elektronike dhe atyre pa djegie , përveçse nëse lejohet sipas ligjeve në fuqi, brenda zonave të caktuara për duhanpirjen.

5. Regjistrimet dhe transmetimi i zërit dhe imazhit

- 5.1. Të gjithë personat që marrin pjesë në finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022 pranojnë, dhe për aq sa është e nevojshme sipas ligjeve në fuqi, japin pëlqimin për t'u fotografuar, filmuar ose incizuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse (dhe/ose çdo palë e tretë e caktuar prej tyre), e cila do të ketë të drejtën e përhershme ose për afatin maksimal të lejuar sipas ligjeve në fuqi, të përdorë, transmetojë, publikojë dhe licencojë, pa asnjë kërkesë për pagesën e parave ose formë tjetër të kompensimit, zërin, imazhin dhe ngjashmërinë e personit të tillë me anë të afishimit të drejtpërdrejtë ose të regjistruar në video dhe/ose audio, transmetimit ose regjistrimit, fotografive ose çdo teknologjie tjetër mediatike aktuale dhe/ose të ardhshme.
- 5.2. Personat që marrin pjesë në finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022 nuk do të mbledhin, marrin, regjistrojnë, përdorin ose transmetojnë në internet, radio, televizion ose çdo media tjetër aktuale ose të ardhshme, asnjë tingull, imazh, regjistrim ose përshkrim të stadiumit ose ndeshjes (duke përfshirë çdo rezultat, statistikë, informacion ose të dhëna të tjera në lidhje me ndeshjen, tërësisht ose pjesërisht) – ose të ndihmojnë ndonjë person që kryen aktivitete të tilla – përveç përdorimit të tyre ekskluziv privat dhe të brendshëm.

6. Sendet dhe sjelljet e ndaluara

- 6.1. Artikujt e mëposhtëm nuk do të sillen në stadium, përveçse në rastet kur autorizohen (sipas rastit) nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse:

- a) çanta më të mëdha se A4 (210 mm x 297 mm x 210 mm);
- b) armë të çdo lloji ose çdo gjëje që mund të përshtatet për përdorim si armë ose predhë;
- c) shishe, kana ose kënaçe të çfarëdo lloji, si dhe objekte të tjera prej plastike, qelqi ose çdo materiali tjetër i brishtë, përveç sendeve të kërkuara për arsye mjekësore të evidentuara siç duhet;
- d) fishekzjarrë, flakë, pluhur tymues, bomba tymuese ose mjete të tjera piroteknike;
- e) kanaçe me spërkatje gazi, substanca gjërryese/të ndezshme, ngjyra ose enë që përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin ose shumë të ndezshme;
- f) tregues lazer;
- g) dronë;
- h) ushqime të çdo lloji, përveç artikujve të kërkuar për arsye mjekësore të evidentuara siç duhet;
- i) alkool, drogë ose substanca të tjera dehëse ose të rrezikshme, përveç substancave të kërkuara për arsye mjekësore të vërtetuara siç duhet;
- j) çdo material fyes, racist, ksenofobik, diskriminim gjinor, fetar, politik ose material tjetër i paligjshëm/i ndaluar, duke përfshirë materiale propaganduese diskriminuese;
- k) çdo objekt ose material promovues, komercial, duke përfshirë banderola, shenja, simbole dhe fletëpalosje;
- l) shtiza flamuri fleksibël që kalojnë 1 (një) metër gjatësi dhe 1 (një) cm në diametër;
- m) banderola ose flamuj më të mëdhenj se 2.0 (dy) x 1.5 (një e gjysmë) metra. Flamujt dhe banderolat më të vogla mund të lejohen, me kusht që të jenë bërë nga materiale që konsiderohen të padjegshme dhe që janë në përputhje me ligjin vendas. Të gjitha banderolat ose flamujt më të mëdhenj se 2.0 (dy) x 1.5 (një e gjysmë) metra lejohen vetëm me një kërkesë me shkrim të konfirmuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse;
- n) pajisje elektronike, mekanike ose manuale që lëshojnë tinguj si megafonat;
- o) kamera dhe videokamera profesionale ose pajisje të tjera profesionale për regjistrimin e zërit ose videove, me mirëkuptimin se kamerat, videokamerat dhe pajisjet e tjera të regjistrimit të zërit ose video mund të sillen në stadium për përdorim privat dhe do të pranohen si të tilla nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse;
- p) të gjitha pajisjet e përdorura për qëllime të transmetimit ose shpërndarjes së çfarëdo përmbajtjeje në kundërshtim me pikën 5.2;
- q) kafshët, me përjashtim të qenve udhërrëfyes dhe/ose ndihmës (me kusht që këta qen udhërrëfyes dhe/ose ndihmës të lejohen të hyjnë në stadium sipas ligjeve në fuqi); dhe
- r) çdo material tjetër që konsiderohet i papajtueshëm, i rrezikshëm dhe/ose i paautorizuar nga autoritetet lokale të sigurisë.

Në rast dyshimi në lidhje me ndonjë objekt të sjellë në stadium, personi përkatës i caktuar nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse, ose një oficer policie, do të jetë përgjegjës për të vendosur se cilat objekte janë të ndaluara ose të lejuara në përputhje me rregullat e stadiumit.

6.2. Ndalohet rreptësisht kryerja e ndonjë prej veprimeve të mëposhtme brenda stadiumit:

- a) hedhja e objekteve ose lëngjeve të çdo lloji, veçanërisht në drejtim të një personi tjetër ose në drejtim të zonës përreth fushës ose brenda në fushë;
- b) ndezja e një zjarri ose lëshimi apo ndezja e fishekzjarrëve, flakët e zjarrit ose mjete të tjera piroteknike;
- c) shprehja ose shpërndarja e mesazheve fyese, raciste, ksenofobike, diskriminuese gjinore, fetare, politike ose të tjera të paligjshme/të ndaluara, veçanërisht mesazhe diskriminuese propaganduese;
- d) veprimi në një mënyrë që mund të interpretohet nga të tjerët si i rrezikshëm, provokues, kërcënues, diskriminues ose fyës;

- e) shitja e mallrave ose biletave, shpërndarja e materialeve (përfshirë materialet e printuara) ose çdo objekt, ose mbajtja e koleksioneve ose kryerja e aktivitete të tjera promovuese ose tregtare pa autorizim paraprak me shkrim nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse, sipas rastit;
- f) ngjitja mbi ose në struktura dhe instalime që nuk janë të destinuara shprehimisht për këtë qëllim;
- g) shkrimi, ngjyrosja ose ngjitja e çdo gjëje në elementë strukturorë, instalime ose vendkalime;
- h) kryerja e nevojave personale jashtë, përveçse në tualete ose ndotja e stadiumit, duke hedhur objekte të tilla si plehra, ambalazhe ose kontejnerë të zbrazur;
- i) qëndrimi në këmbë mbi ulëset në zonat e tifozëve;
- j) maskimi ose kamuflimi i vetes (veçanërisht i fytyrës) në një mënyrë që pengon njohjen; dhe
- k) çdo sjellje tjetër që është e ndaluar.

Lista e mësipërme nuk është gjithëpërfshirëse.

6.3. Përveçse nëse autorizohet ndryshe nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse, veprimet e mëposhtme do të ndalohen rreptësisht brenda stadiumit:

- a) qasja në zonat (p.sh. dhomat e funksionit ose zonat VIP dhe media) të cilat janë të mbyllura për publikun ose për të cilat qasja është e kufizuar për mbajtësit e një bilete, akreditimi dhe/ose, sipas rastit, pajisjeje shtesë aksesit, nëse personi në fjalë nuk ka të drejtën për të hyrë në zona të tilla;
- b) kufizimi ose lëvizja në zonat e hapura për trafikun, trotualet dhe rrugët, hyrjet dhe daljet në zonat e vizitorëve dhe daljet e emergjencës; dhe
- c) futja në fushë ose në zonën përreth fushës.

Lista e mësipërme nuk është gjithëpërfshirëse.

7. Shkelja e rregullave të stadiumit

Në varësi të çdo ligji në fuqi, çdo shkelje e rregullave të stadiumit mund të shoqërohet me gjobë si më poshtë:

- a) përjashtimi nga stadiumi dhe një denoncim i mundshëm në polici;
- b) ndalimi i shkelësit nga stadiumi për një pjesë ose të gjithë kohëzgjatjen e finales së UEFA Europa Conference League™ 2022, në përputhje me termat dhe kushtet e akreditimit ose termat dhe kushtet e biletave, sipas rastit,
- c) anulimi dhe pavlefshmëria, pa të drejtë rimbursimi, e biletës dhe e çdo bilete tjetër që është blerë ose marrë nga personi shkelës për finalen e UEFA Europa Conference League™ 2022, në përputhje me termat dhe kushtet e biletave,
- d) dhënia, në përputhje me ligjet në fuqi, të informacionit personal të shkelësit për shoqatat përkatëse kombëtare të futbollit dhe/ose policinë, në mënyrë që të mund të merren masat e duhura (p.sh. ndalimi në stadiumet kombëtare),
- e) fillimi i procedurave ligjore nga UEFA dhe/ose shoqata pritëse ose ndonjë person apo ent tjetër i autorizuar; dhe/ose
- f) dënimet ose mjetet juridike në përputhje me ligjet në fuqi.

UEFA dhe/ose shoqata pritëse rezervojnë të drejtën për të ndjekur çdo mjet tjetër juridik sipas gjykimit të tyre.

8. Vëzhgimi me video

Për të garantuar sigurinë e publikut, stadiumi është i pajisur me një sistem vëzhgimi me video kontrolluar nga shoqata pritëse, oficerët e policisë gjyqësore ose oficerët e sigurisë private, imazhe të cilat ka të ngjarë të përdoren në rast të procedimeve ligjore. E drejta e qasjes parashikohet në përputhje me ligjin vendas.

9. Përgjegjësia

Brenda kufijve të vendosur nga ligjet në fuqi, personat që hyjnë në stadium pranojnë se e bëjnë këtë duke marrë përsipër rrezikun e tyre dhe se mund të jenë përgjegjës për dëmet ose humbjet që vijnë nga veprimet e tyre në stadium.

10. Ndarshmëria dhe ndryshimet

- 10.1. Nëse ndonjë dispozitë e rregullave të stadiumit shpallet e pavlefshme, e paefektshme ose e pazbatueshme nga ndonjë gjykatë kompetente, pjesa e mbetur e rregullave të stadiumit do të mbetet në fuqi, sikur ato dispozita të pavlefshme, të paefektshme ose të pazbatueshme të mos kishin ekzistuar.
- 10.2. UEFA dhe shoqata pritëse rezervojnë të drejtën për të bërë ndryshime të arsyeshme në rregullat e stadiumit herë pas here, versioni më i fundit dhe efektiv i të cilave do të jetë i disponueshëm në faqen zyrtare të UEFA-s në adresën www.uefa.com/tirana

11. Tekst autentik

Rregullat e stadiumit janë hartuar në anglisht dhe janë përkthyer në shqip. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet teksteve, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

12. Ligji dhe juridiksioni në fuqi

- 12.1. Rregullat e stadiumit do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me ligjet e Shqipërisë.
- 12.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ose lidhen me rregullat e stadiumit do t'i paraqiten gjykatës kompetente në Shqipëri.

Shtojca

NDALOHET PIRJA E DUHANIT, PËRVEÇSE NË ZONAT E LEJUARA

Lista jo e plotë e artikujve të ndaluar

PROHIBITED ITEMS



Bags larger than A4



No Smoking



Umbrellas and helmets



Laser pointers



Bottles*, jugs, cans, glass, etc.



Pyrotechnics



Alcoholic drinks and drugs*



Racist, xenophobic, political and religious propaganda materials



Flagpoles more than 1m in length and 1cm in diameter



Flags larger than 2.0m x 1.5m (6.5' x 5.0')



Professional cameras or video cameras



Weapons, explosives, knives, or anything that could be adapted for use as a weapon



Promotional or commercial objects or materials



Aerosol sprays



Face covering



Drones



Mechanical or electronic sound-emitting devices, such as megaphones

* me përjashtim të arsyeve mjekësore të evidentuara siç duhet